



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
DREJTORIA EKONOMIKE

PROJEKT VENDIM

“ Mbi Perdorimin e Fondeve te Grantit te Performances per Bashkite per Vitin 2025”

Ne zbatim, ne Ligjin 68 date 24/04/2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore”,ne Udhezimin nr 2 te Ministrise se Financave date 24.01.2025 “Per Zbatimin te Buxhetit te vitit 2025”, te Ligjit nr 115/2024 “Per Buxhetin e vitit 2025 “, te ndryshuar , aneksit nr 9 “Granti i Performances per bashkite”si dhe ne mbeshteje Udhezimit te perbashket te Ministrit te Financave dhe Ministrit te Shtetit per Pushtetin Vendor nr.1031/5 date 11.07.2025 dhe nr. 10725 date 11.07.2025 ,”Per kriteret ,procedurat,treguesit per shperndarjen e fondit te Gantit te Bazuar ne Performance per bashkite per vitin 2025” si dhe ne vijim te shkreses se Agjencise per Mbeshtetjen Vendore nr. 764 prot date 19.12.2025,ku percillet Vendimi i Komisionit te Vleresimit te Aplikimeve per miratimin e fondit te Grantit te Bazuar ne Performance,per shumen totale 11,054,832.76 leke.Ky grant ka dy burime financimi, burim i brendshem dhe burim i Huaj te detajuara shumat si ne tabelen e meposhteme.

Kodi i Institucionit	Emri i Institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Dega Thesarit	Emertimi i produktit	Burim i Brendshem	Burim i Huaj
2108001	Bashkia Shijak	01	04960	6040000	0707	Grant Performance	4,943,820.22	6,111,012.53

Duke qene se bashkia Shijak eshte shpalluar fituese e tre projekteve nga Komisionit te Vleresimit te Aplikimeve me objekt:

1.Projekti i “Plani i Mbareshtimit te Pyjeve “,2.“Plani i Arsimit Parauniversitar” dhe 3.“Plani i Barazise Gjimore”,Grupi per Menaxhim Strategjik(GMS) propozon te paraqesim per miratim qe

Adresa: Lagja “Erzen” Shijak, Tel: +35557122152, website: www.shijak.gov.al, e-mail:info@shijak.gov.al

fondi i performances nga burimi i huaj per shumen 6,111,012.53 leke te perdoret ne zbatim te projektit "Plani i Arsimit Parauniversitar" per te pajisur te gjithë ambientet e shkolles "Muharrem Dollaku" ne Shijak me sistem ngrohje, duke plotesuar keshtu standartin per kushte optimale te femijeve ne shkolla.

Ndersa shuma nga fondi i performances per 4,943,820.22 leke te perdoret ne zbatim te projektit "Plani i Barazise Gjinore", me qellim rehabilitim dhe arredim te 2 ambienteve ne katet e para tek pallatet e reja per ti pershtatur ne vende pushimi dhe argetimi ditore per moshen e trete ,projekti i investimit do te kete objekt "Qender Ditore Multifunkionale per te Moshuarit" dhe krijimin e nje qendre ditore ne mbeshtetje te rasteve te dhunes ne familje, ambiente te cilat jane te domosdoshme, dhe do te sherbejne deri ne marrjen drejtim te zgjidhjeve ligjore te rasteve respektive, per ti referuar me tej ne strukturat perkatese qe kane kapacitetet e duhura per nevojat e tyre. Projekti i investimit do te kete objekt "Qender Keshillimi e Specializuar per Barazine Gjinore dhe Parandalimin e Dhunes ne Familje"

Faleminderit!

DREJTORESHA EKONOMIKE

Pranvera Alushi



SEKRETARI I KËSHILLIT

Kozeta Doda



JURISTJA

Xhuana Keçi



KRYETARI I BASHKISË

Elton Arbana



Adresa: Lagja "Erzen" Shijak, Tel: +35557122152, website: www.shijak.gov.al, e-mail: info@shijak.gov.al